



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.2,  
Dhjetor 2017

## AGRESIVITETI NË ADOLESHENCË DHE LIDHJA E TIJ ME ATASHIMIN

Eglantina Dervishi\*, Silva Ibrahimii\*\*

\*Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

\*\*Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, “Albanian University”, Tiranë, Shqipëri

**Adresë kontakti:** *egladervishi@gmail.com*

### Përmbledhje

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë shfaqjen e sjelljeve agresive në moshën e adoleshencës dhe lidhjen e saj me tipin e atashimit me figurat kujdestare, nënën dhe babain nisur nga këndvështrimi i adoleshentëve.

Studimi është realizuar gjatë periudhës 2016 - 2017 në 6 gjimnaze të qytetit të Tiranës. Kampioni ishte 693 adoleshentë, të moshës 16 - 20 vjeç. U përdor *Inventari i atashimit me prindërit* (IPPA) (Armsden, Greenberg, 1987) i përbërë nga 50 pyetje, si dhe *Pyetësori mbi agresivitetin* (Buss, Perry, 1992) me 12 pyetje të tipit Likert, i cili eksploron katër dimensionet e agresivitetit.

Rezultatet e studimit treguan se ka rëndësi të madhe mënyra e komunikimit me prindërit dhe lidhja me shfaqjen e disa sjelljeve agresive. Ka dallime të dukshme midis femrave dhe meshkujve për sa u përket sjelljeve agresive.

Si përfundim, mund të themi se lidhja e figurave prindërore me dy format e agresivitetit thekson rëndësinë që ka krijimi i urave të sigurta të komunikimit përgjatë gjithë zhvillimit të tyre si një bazë për përshtatjen me qasje pozitive kundrejt mjedisit.

**Fjalë çelës:** *atashim, nënë, baba, adoleshent, agresivitet.*

## AGRESSIVITY IN ADOLESCENCE AND ITS CONNECTION TO ATTACHMENT

### Abstract

The aim of the present research is to explore the manifestation of aggressive behaviors in the years of adolescence and its relation to the type of attachment with caregivers such as the mother and father, starting from the teenage point of view. The study was conducted during the 2016 - 2017 in 6 high schools of the city of Tirana.

The sample included 693 teenagers aged 16 - 20 years old. We used the Parent's Attachment Inventory (IPPA) (Armsden, Greenberg, 1987) that consists of 50 questions and the Questionnaire on Aggression (Buss, Perry, 1992) with 12 Likert - type questions exploring four dimensions of aggressiveness.

The results of the study revealed that it is of great importance in the way of communication with parents and the connection with the emergence of some aggressive behaviors. There are obvious differences between males and females regarding aggressive behavior.

As a conclusion we could refer that the linkage of parental figures with two forms of aggression emphasizes the significance of creating safe communication bridges throughout their development as a basis for adaptation with a positive approach to the environment.

**Key words:** *attachment, mother, father, adolescent, aggressivity.*

## Hyrje

Adoleshenca përshkruhet nga kërkuesit dhe profesionistët e shëndetit mendor që i janë dedikuar praktikës klinike (1), si një moshë tepër delikate për t'u menaxhuar nga kujdestarët e tyre ligjorë. Për prindërit bëhet e vështirë të kuptohen dhe të kontrollohen shpërthimet e vrullshme psiko-emocionale dhe ato agresive (2). Sipas teorisë së atashimit (3), përvojat personale të një fëmije me kujdestarin e tij primar janë baza për modelimin në vazhdimësi të zhvillimit të tij social dhe të personalitetit. Është konstatuar se një marrëdhënie me figurat e kujdesit primare pozitive të karakterizuara nga një kohezion pozitiv midis prindit dhe adoleshentit, mbështetja, besimi, midis tyre, komunikimi i hapur dhe empatik favorizon zhvillimin psiko-emocional të tij. Ndërkohë që konteksti ku adoleshenti nuk i kushtohet vëmendje dhe braktiset në fatin e tij, shihet si një faktor risku i drejtpërdrejtë lidhur me problematikën e shfaqjes së sjelljeve agresive, braktisjen e shkollës herët, abuzimin me substancat dhe përfshirjen e mundshme në veprimtari kriminale (4) etj. Atashimi i sigurt (5) i figurave të kujdesit primar me adoleshentin është një shans më tepër për të pasur mundësi të vazhdojmë të ndikojmë pozitivisht në mënyrën se si adoleshenti aftësohet për t'i dhënë kuptim ekzistencës (6) së tij. Por gjithashtu shërben dhe si një pikë e fortë e mënyrës se si ai menaxhon veten në kontekste të ndryshme sociale (7), si një individ i përgjegjshëm. Përgjatë rrugës së zhvillimit në të cilën kalon, adoleshenti ka mësuar dhe do të shfaqë ato forma të komunikimit që janë instaluar shumë herët (8), dhe pikërisht në adoleshencë ato konsolidohen duke u brendësuar në një mënyrë më të qëndrueshme dhe duke u shkrirë me trajtat e personaliteti të tij (9). Komunikimi më i hapur ndihmon të shihet si faktor i rëndësishëm në kalimin e kësaj kohe të tranzicioneve dhe ndryshimeve (10), në terma të pranimit të nevojave të reja dhe dëshirave të adoleshentit.

Është vënë re se familjet që kanë një komunikim më të mirë (11), kanë strukturë dhe rregull në mënyrën se si funksionojnë, janë më tepër në gjendje të përballen me tranzicionet e adoleshencës. Kjo do të thotë se sa më i mirë komunikimi me prindërit në adoleshencë, sa më të qarta pozicionet dhe rregullat përgjatë kohës, aq më e madhe është ndjenja e sigurisë në kalimin e stadeve, aq më i lehtë për t'u menaxhuar ankthi dhe pasiguria që vjen nga gjithçka që po ndodh brenda adoleshentit, por qetësohet kur familja i ofron të rutinë të stabilizuar dhe të njohur për të. Kjo krijon një bazë për komunikim më të mirë edhe me të tjerët përgjatë jetës. Mungesa e komunikimit midis nënës dhe adoleshentit duket se lidhet me shfaqjen e formave të zemërimit (12) si një kundërpërgjigje kundrejt mungesës së sigurisë. Ndërkohë, nga ana tjetër, mungesa e një komunikimi të hapur me figurën e babait shfaqet si tregues i rëndësishëm i agresivitetit verbal të adoleshentëve (13). Lidhja e figurave prindërore me dy

format e agresivitetit (14) thekson rëndësinë që ka krijimi i urave të sigurta të komunikimit përgjatë gjithë zhvillimit (15) të tyre si një bazë për përshtatje me qasje pozitive kundrejt mjedisit. Kështu adoleshentët të cilët kishin një komunikim pozitiv me prindërit, ishin më pak të prirur për t'u përfshirë në sjellje me tendenca të agresivitetit verbal (16) dhe zemërimit. Shoqëria në ditët e sotme ka pritshmëri të njëjta përsa u përket dy roleve prindërore nisur nga rëndësia e dy figurave nënë dhe baba në atashim, por jo gjithmonë ka pritshmëri të njëjta për përkushtimin që rolet kanë kundrejt familjes. Duket se ekziston një lidhje midis prindërve dhe agresivitetit, por sigurisht që konkluzione të qarta lidhur me madhësinë e kësaj lidhjeje janë të vështira për t'u nxjerrë. Një arsye e rëndësishme për këtë vështirësi është heterogjeniteti i studimeve dhe gjetjeve të tyre në këtë fushë të hulumtimit. Studimet ndryshojnë nga llojet e agresivitetit deri në sjellje rriskuese apo kriminale dhe dimensionet e prindërve që janë hulumtuar mbi mënyrën se si maten këto konstruksione dhe mbi popullatat nga të cilat janë nxjerrë mostrat. Meshkujt priren të jenë më agresivë në krahasim me femrat në periudhën e adoleshencës (17). Meshkujt janë më të përfshirë në sjelljen agresive rriskuese se femrat, jo vetëm kur bëhet fjalë për agresivitet fizik, por edhe verbal (18) si në rastin konkret. Meshkujt mund të jenë më të prekshëm ndaj faktorëve të rrezikut për të shfaqur sjellje agresive lidhur kjo me modelin e prindërimit joadekuat (19), krahasuar me femrat. Një tjetër këndvështrim është se faktorët e rrezikut për format e agresivitetit janë të njëjta, por që meshkujt janë të ekspozuar ndaj faktorëve të rrezikut më shumë se femrat. Këto transaksione negative të fëmijëve rrisin rrezikun e vendosjes së tij në një rrugë të sjelljeve rriskuese që fillon në adoleshencën e hershme (20), dhe përfshin shumë sjellje rriskuese që çojnë adoleshentin drejt kriminalitetit dhe vazhdon deri në moshë madhore. Kjo qasje e shfaqjes së sjelljeve agresive në fillimin e adoleshencës thekson rëndësinë e studimit të një kampioni të caktuar, si në rastin konkret (adoleshentë të moshës 16 - 20 vjeç), duke nxjerrë në pah tendencat mesatare të agresivitetit, të cilat kanë prirje të shtohen me rritjen e moshës. Shumë prindër mendojnë se ata kanë pak ose aspak ndikim në jetën e fëmijëve të tyre adoleshentë (21) dhe i shqetëson fakti se fati i fëmijës së tyre qëndron jashtë duarve të tyre. Është e rëndësishme që miti i shkëputjes së adoleshentëve nga prindërit të konceptohet si një proces i natyrshëm dhe i nevojshëm për adoleshentin, i cili fillon të krijojë pavarësi dhe marrëdhënie të tjera atashuese (22) jashtë familjes. Sugjerohet se prindërit janë burimi kryesor i socializimit dhe zhvillimit moral (23) për të rinjtë gjatë fëmijërisë. Adoleshentët të cilët ndihen të kuptuar nga prindërit e tyre dhe besojnë në përkushtimin e tyre ndaj marrëdhënieve të krijuara, lëvizin me besim dhe siguri (24) drejt moshës së rritur të hershme. Adoleshentët me lidhje jo të mira e shmangin konfliktin, eksplorimin dhe individualizimin (25), shtyhen para kohe për të qenë të pavarur dhe pa mbështetjen e prindërve të tyre, duke brendësuar si pjesë të sjelljes së tyre edhe agresivitetin.

### Metoda

Ky është një studim i llojit korrelacional përshkrues që synon të eksplorojë lidhjen e dimensioneve të atashimit të adoleshentëve me prindërit me dimensionet e agresivitetit, nëpërmjet vetëraportimit, si dhe matjen e ndikimit të faktorëve si mosha apo gjinia në perceptimin e adoleshentëve në lidhje dimensionet e atashimit dhe format e agresivitetit.

Atashimi i pasigurt me figurat e kujdesit primar lidhet nivelet e larta të agresivitetit tek adoleshentët. Gjinia shihet si faktor risku për shfaqjen e sjelljeve agresive. Kampioni përbëhej nga 693 (N = 693) nxënës në katër gjimnaze të Tiranës, të cilëve u është kërkuar që të marrin pjesë vullnetarisht në studim. Është realizuar një përzgjedhje me konvenciençë e këtyre shkollave të Tiranës, nisur nga mundësitë e kufizuara për të patur akses në shkolla të tjera. Numri i përgjithshëm i kampionit është 693, ndërkohë që popullata e kësaj shkollë është afërsisht 3150 nxënës.

Instrumentet e përdorur në këtë studim ishin: *Inventari i atashimit me prindërit* (IPPA) (Armsden & Greenberg, 1987). Çdo adoleshenti iu kërkuar të plotësonte IPPA, një pyetësor vetëraportues, që përfshin 50 pika që janë dizenuar të masin atashimin e përgjithshëm e adoleshentit me prindërit. Përkatesisht në pyetësor 25 pohimet e para masin atashimin me nënën dhe përbëjnë pjesën e parë të pyetësorit, dhe 25 pohimet e tjera masin atashimin me babain dhe përbëjnë pjesën e dytë të pyetësorit janë sipas shkallës Likert. *Pyetësori i Agresionit* është analizuar në vitin 2001 dhe është sjellë në një formë të shkurtuar me 12 pyetje të zgjedhura nga Bryant dhe Smith në universitetin Loyola të Chicagos, ndërkohë që versioni origjinal përmban 29 pyetje (Buss dhe Perry, 1992). Për të analizuar besueshmërinë e instrumenteve të përdorur për këtë studim është përdorur koeficienti i Crombach, i cili kapi këto vlera  $\alpha = .870$  në total për atashimin, dhe  $\alpha = .799$  për agresivitetin.

## Rezultatet

Rezultoi një tendencë kryesore e pjesëmarrjes së moshës 17 dhe 18 vjeç. Mosha duket të jetë e larmishme, edhe pse pyetësori u plotësua vetëm në vitet e dyta dhe të treta të gjimnazeve, pasi në vitin e tretë ka nxënës që nuk kanë mundur të mbyllin ciklin e studimit në moshën e duhur për shkak të rezultateve jokalueve në shkollë. Mosha e pjesëmarrësve në këtë studim varion nga 16 vjeç deri në 20 vjeç. Nga statistika përshkruese duket se 3.1 %, e subjekteve ishin të moshës 16 – vjeç, 45.1 % e subjekteve ishin të moshës 17 - vjeç, 46.6% e subjekteve ishin të moshës 18 vjeç, 4.1 % e subjekteve ishin të moshës 16 - vjeç, 1% e subjekteve ishin të moshës 20 vjeç. Të dhënat tregojnë se 427 subjekte janë të gjinisë femër ose 65.8 % dhe 266 subjekte janë të gjinisë mashkull ose 34.2 % e totalit të pjesëmarrësve. Kjo e dhënë vë në dukje një pjesëmarrje më të lartë të femrave në studim si pasojë e plotësimit të pyetësorit që përkonte me fundin e shkollës, e si rrjedhojë, pjesa më e madhe e meshkujve mungonin në ditën e plotësimit të pyetësorit. Marrëdhënia atashuese me nënën rezulton të jetë ( $\bar{X}(\bar{X} = 89)$ ), me babain rezulton të jetë ( $\bar{X}(\bar{X} = 85)$ ), që interpretohen si nivel mesatar atashimi, referuar edhe vlerave të pyetësorit IPPA (60 – 90 pikë - nivel mesatar atashimi). Duket se atashimi me nënën shfaqet me i sigurt ( $\bar{X}(\bar{X} = 89)$ ) në krahasim me atashimin me babain ( $\bar{X}(\bar{X} = 85)$ ), edhe pse me një diferencë të vogël midis tyre. Tabela e korrelacionit tregon se dimensionet e atashimit me nënën tek adoleshentët korrelojnë negativisht me dimensionet e agresivitetit, por vlerat e (rho), siç vërehet edhe në tabelën e mësipërme, nuk shënojnë shifra të larta, gjë që tregon një lidhje të ulët midis dy dimensioneve.

**Tabela 1. Korrelacioni i dimensioneve të atashimit me nënën me dimensionet e agresivitetit (N = 693)**

|                                           | <b>Rho</b> | <b>P</b> |
|-------------------------------------------|------------|----------|
| Besimi tek nëna - Armiqësi                | - .048     | .509     |
| Komunikimi tek nëna - Armiqësi            | - .062     | .390     |
| Inat tek nëna - Armiqësi                  | - .136     | .059     |
| Besimi tek nëna - Agresiviteti verbal     | - .149     | .038     |
| Komunikimi tek nëna - Agresiviteti verbal | - .153     | .034     |
| Inat tek nëna - Agresiviteti verbal       | - .097     | .179     |
| Besimi tek nëna - Agresiviteti fizik      | - .195     | .004     |
| Komunikimi tek nëna - Agresiviteti fizik  | - .142     | .049     |
| Inat tek nëna - Agresiviteti fizik        | .102       | .157     |
| Besimi tek nëna - Zemërimi                | - .108     | .136     |
| Komunikimi tek nëna - Zemërimi            | - .192     | .008     |
| Inat tek nëna - Zemërimi                  | - .102     | .157     |

Ndër vlerat më të larta në tabelë kemi korrelimin e dimensionit të besimit tek nëna me dimensionin agresivitet fizik tek adoleshentët ( $r = -.195$ ,  $p = .004$ ,  $n = 193$ ), që interpretohet me praninë e një korrelacioni të ulët negativ midis dy dimensioneve. Pra rezulton se kjo marrëdhënie është statistikisht domethënëse, pasi ( $p > .005$ ). Ndërkohë ndër vlerat më të ulëta rezulton dimensionin i besimit tek nëna me dimensionin armiqësi tek adoleshentët ( $r = -.048$ ,  $p = .509$ ,  $n = 193$ ) që interpretohet me mungesën e korrelacionit midis dy dimensioneve. Pra rezulton se kjo marrëdhënie nuk është statistikisht domethënëse pasi ( $p > .005$ ). Referuar edhe studimeve të ndryshme, është konstatuar që lidhjet familjare pozitive janë karakterizuar nga një kohezion pozitiv midis prindit dhe fëmijës, mbështetja, besimi, midis tyre, komunikimi i hapur dhe empatik favorizon zhvillimin emocional të psikologjisë së fëmijës dhe në të kundërt, lidhja familjare negative është një kontekst ku nuk ekziston asnjë prej komponentëve të përmendur dhe që shihet si një nga faktorët e riskut më të drejtpërdrejtë të lidhur me problematikën te fëmijët dhe adoleshentët.

**Tabela 2. Korrelacioni i dimensioneve të atashimit me babain me dimensionet e agresivitetit (N = 693)**

|                                            | <b>rho</b> | <b>P</b> |
|--------------------------------------------|------------|----------|
| Besimi tek babai - Armiqësi                | - .119     | .099     |
| Komunikimi tek babai – Armiqësi            | - .066     | .359     |
| Inat tek babai – Armiqësi                  | - .174     | .016     |
| Besimi tek babai - Agresiviteti verbal     | - .215     | .003     |
| Komunikimi tek babai - Agresiviteti verbal | - .109     | .130     |
| Inat tek babai - Agresiviteti verbal       | - .164     | .023     |
| Besimi tek babai - Agresiviteti fizik      | - .208     | .004     |
| Komunikimi tek babai - Agresiviteti fizik  | - .055     | .445     |
| Inat tek babai - Agresiviteti fizik        | .003       | .962     |
| Besimi tek babai – Zemërimi                | - .133     | .064     |
| Komunikimi tek babai - Zemërimi            | - .055     | .451     |
| Inat tek babai – Zemërimi                  | - .198     | .006     |

Tabela e korrelacionit tregon se dimensionet e atashimit me babain tek adoleshentët korrelojnë negativisht me dimensionet e agresivitetit, përveç dimensionit të inatit tek babai me agresivitetin fizik ku lidhja është pozitive ( $r = .003$ ), gjithashtu vlerat e ( $\rho$ ), siç vërehet edhe në tabelën e mësipërme, nuk shënojnë shifra të larta, gjë e cila tregon një lidhje të ulët midis dy dimensioneve. Ndër vlerat më të larta në tabelë kemi korrelimin e dimensionit të besimit tek babai me dimensionin agresivitet verbal tek adoleshentët ( $r = -.215$ ,  $p = .003$ ,  $n = 193$ ), që interpretohet me praninë e një korrelacioni të ulët negativ midis dy dimensioneve ( $p < .005$ ). Pra rezulton se kjo marrëdhënie është statistikisht domethënëse pasi  $p < .005$ . Ndërkohë, ndër vlerat më të ulëta rezulton dimensionin “inat tek babai” me dimensionin agresivitet fizik tek adoleshentët ( $r = -.003$ ,  $p = .962$ ,  $n = 193$ ), që interpretohet me mungesën e lidhjes midis dy dimensioneve. Pra rezulton se kjo marrëdhënie nuk është statistikisht domethënëse pasi ( $p > .005$ ).

Të dhënat e nxjerra nga analiza korrelacionale mundësojnë një pamje më të qartë të lidhjes që ekziston midis tre dimensioneve të atashimit me nënën dhe babain me katër dimensionet e agresivitetit tek adoleshentët. Qartësisht kemi një lidhje negative të dimensioneve me njëri-tjetrin, si tek atashimi me nënën, ashtu edhe me babain, gjë e cila tregon ngjashmëritë e dukshme midis dy figurave prindërore, si dhe faktin e rëndësishëm se, pavarësisht se lidhja që ekziston është e ulët, ajo tregon një shoqërim negativ të dimensioneve të mësipërme. Adoloshentët të cilët kishin marrëdhënie pozitive me prindërit, ishin më pak të prirur për t’u përfshirë në sjellje me tendencë agresive e në të njëjtën kohë riskuese, ndërsa ata të cilët kishin marrëdhënie problematike me prindërit, kishin më shumë gjasa për të reaguar përmes sjelljeve delinkuente dhe joadaptive.



**Tabela 3. Statistika përshkruese për diferencat gjinore tek agresiviteti (N = 693)**

| Gjinia                         | N   | Mesorja | Devijimi Standard | Mesatarja |
|--------------------------------|-----|---------|-------------------|-----------|
| Agresiviteti - gjinia femër    | 427 | 28.2205 | 8.46178           | 26.0000   |
| Agresiviteti - gjinia mashkull | 266 | 29.8636 | 9.07725           | 28.0000   |

Tabela tregon një pjesëmarrje në studim të 427 femrave dhe 266 meshkujve, prej të cilëve mesatarisht meshkujt tregojnë një agresivitet më të lartë ( $\bar{XX} = 28$ ) krahasuar me femrat në studim, të cilat shfaqin vlera më të ulëta të agresivitetit ( $\bar{XX} = 26$ ). Kjo e dhënë nga analiza statistikore na vërteton edhe hipotezën e fundit, sipas së cilës meshkujt prirën të jenë më agresivë në krahasim me femrat në periudhën e adoleshencës. Ndërkohë, në studimin e kryer në lidhje me analizimin e diferencave gjinore (26) me të njëjtën shkallë AQ, të Buss dhe Perry në perceptimin për shfaqjen e tendencave agresive (27), meshkujt e përshkruan veten e tyre si më agresive se ferat ( $p < .001$ ), rezultate të cilat janë në të njëjtën linjë me perceptimin e adoleshentëve meshkuj në kërkimin tonë.

**Tabela 4. Statistika përshkruese për diferencat gjinore tek dimensionet e agresivitetit (N = 693)**

| Gjinia                                | N   | Mesorja | Devijimi Standard | Mesatarja |
|---------------------------------------|-----|---------|-------------------|-----------|
| Armiqësi - gjinia femër               | 427 | 7.8268  | 2.76915           | 7.0000    |
| Zemërim - gjinia femër                | 427 | 7.5039  | 3.03125           | 7.0000    |
| Agresiviteti fizik - gjinia femër     | 427 | 5.3858  | 2.47863           | 5.0000    |
| Agresiviteti verbal - gjinia femër    | 427 | 7.5039  | 2.57236           | 7.0000    |
| Armiqësi - gjinia mashkull            | 266 | 7.1970  | 2.75245           | 7.0000    |
| Zemërim - gjinia mashkull             | 266 | 7.7576  | 2.71781           | 7.0000    |
| Agresiviteti fizik - gjinia mashkull  | 266 | 7.0000  | 3.39683           | 6.0000    |
| Agresiviteti verbal - gjinia mashkull | 266 | 7.9091  | 2.58235           | 8.0000    |

Tabela e mësipërme paraqet në mënyrë të detajuar lidhjen e gjinisë së pjesëmarrësve me dimensionet specifike të agresivitetit për të gjetur në cilat forma të shfaqjes së agresivitetit ndryshojnë femrat nga meshkujt në studim. Agresiviteti fizik që shfaqin femrat, rezultojnë mesatarisht më e ulët ( $\bar{XX} = 5$ ) krahasuar me vlerat e nivelit mesatar të agresivitetit që shfaqin meshkujt ( $\bar{XX} = 6$ ). Ndërkohë agresiviteti verbal që shfaqin femrat, rezultojnë mesatarisht vlerë më e ulët ( $\bar{XX} = 7$ ) krahasuar me vlerat e nivelit mesatar të agresivitetit që shfaqin meshkujt në studim ( $\bar{XX} = 8$ ). Nga studimi rezultojnë se meshkujt mesatarisht shfaqin vlera më të larta të agresivitetit, specifikisht në format e agresivitetit fizik dhe verbal, ndërkohë që, përsa i përket formave të agresivitetit siç është zemërimi apo armiqësia, vërejmë që mesatarisht të dyja gjinitë shfaqin të njëjtat vlera, siç tregohen edhe në tabelën e mësipërme. Në analizën e bërë kanë rezultuar disa diferenca gjinore të pjesëmarrësve në studim në lidhje me perceptimin për shfaqjen e

agresivitetit, por sigurisht ajo që vlen të përmendet, është se diferencat për të dy gjinitë në shfaqjen e agresivitetit në bazë të vetëraportimeve të adoleshentëve janë të ulëta, si dhe lënë vend për diskutim, nisur na fakti se si pjesëmarrësit e perceptojnë veten e tyre. Gjithashtu, duhet përmendur fakti se përballja me termin agresivitet mund të ndikojë në krijimin e tendencave të përjashtimit të lidhjeve të vetes dhe egos me të.

### Përfundime

Është konstatuar që një atashim pozitiv midis prindit dhe adoleshentit bazuar në mbështetjen pa kushte, klimën e besimit që duhet të karakterizojë marrëdhënien midis tyre dhe komunikimi i hapur dhe i sinqertë favorizon zhvillimin psiko - emocional të fëmijës dhe në të kundërt, neglizhenca dhe kontrolli mbytës bashkëshoqëruar edhe me izolim shihet si një faktor risku i drejtpërdrejtë lidhur me problematikën e shfaqjes së sjelljes agresive tek adoleshentët. Aftësia e prindërve dhe fëmijëve për të komunikuar me njëri-tjetrin, lidhet me sigurinë në atashim. Komunikimi midis prindërve edhe fëmijëve ndryshon ndërsa fëmijët kalojnë në stade të ndryshme zhvillimi. Komunikimi më i hapur ndihmon në të kuptuarit të tranzicionit dhe ndryshimit gjatë kësaj kohe, në terma të pranimi të nevojave të reja dhe të dëshirave të adoleshentëve. Klima e sigurt familjare ndihmon adoleshentët të përballen me tranzicionin e moshës. Kjo do të thotë se sa më i mirë komunikimi me prindërit në adoleshencë, aq më e madhe është ndjenja e sigurisë në kalimin e stadeve. Kjo krijon një bazë për komunikim më të mirë edhe me të tjerët gjatë jetës. Mungesa e komunikimit midis nënës dhe adoleshentit duket të lidhet me shfaqjen e formave të zemërimit si një kundërpërgjigje kundrejt mungesës së sigurisë. Ndërkohë nga ana tjetër, mungesa e një komunikimi të hapur me figurën e babait shfaqet si tregues i rëndësishëm i agresivitetit verbal të adoleshentëve. Lidhja e figurave prindërore më dy format e agresivitetit thekson rëndësinë që ka krijimi i urave të sigurta të komunikimit përgjatë gjithë zhvillimit të tyre si një bazë për përshtatje me qasje pozitive kundrejt mjedisit. Kështu adoleshentët të cilët do të kenë një komunikim pozitiv me prindërit, do të jenë më pak të prirur për t'u përfshirë në sjellje me tendenca agresive dhe sjellje rriskuese.

### Referenca

1. Segrin, C., & Flora, J. (2005). Family Communications. Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, (aksesuar më: 13/05/2017).
2. Scott, W. Richard. "The adolescence of institutional theory. Administrative science quarterly, Journal of Counseling Psychology, (aksesuar më: 27/06/2017).
3. Ainsworth, M. D. S., Blehar, M. C., Waters, E., & Wall, S. (1978). Patterns of attachment: A psychological study of the strange situation. Hillsdale, NJ: Erlbaum.
4. Ovejero, A. (2017). Cyberbullying victimization in higher education: An exploratory analysis of its association with social and emotional factors among Spanish students. *Computers in Human Behavior*, (25/06/2017).
5. Bowlby, J. (1988). A secure base: Parent - child attachment and healthy human development, New York: Basic Books, (2), p. 125 - 155.
6. Herrero, J., Estévez, E., and Musitu, G. (2005). Deviant behaviour and victimization at school. *Journal of Counseling Psychology*. pp. 210 - 218.
7. Bowlby, J. (1988). A secure base: Parent - child attachment and healthy human development, New York: Basic Books, (2), p. 125 - 155.
8. Hazan, C., & Shaver, P. R. (1994). Attachment as an organizational framework for research on close relationships. *Psychological Inquiry*, 5, pp. 1 - 22.



9. Gullone. E, Robinson. K. (2005) The Inventory of Parent and Peer Attachment—Revised (IPPA - R) for Children: A Psychometric Investigation, Researchgate, 12, 67 - 79.
10. Guarnieri, S., Ponti, L., & Tani, F. (2010) Adolescent parent and peer attachment, Researchgate.
11. Freitag, M. K., Belsky, J., Grossman, K., Grossman, K. E., & Scheuerer - Englisch, H. (1996). Continuity in parent - child relationships from infancy to middle childhood and relations with friendship competence. *Child Development*, 67, 1437 - 1454.
12. Bell, N. J., Forthun, L. F., & Sun, S. W. (2000). Attachment, adolescent competencies, and substance use: Developmental considerations in the study of risk behaviors. *Substance use & misuse*, 35(9), 1177 - 1206.
13. Fred B. Bryant and Bruce D. Smith (2001). Refining the Architecture of Aggression: A Measurement Model for the Buss-Perry Aggression Questionnaire, *Journal of Research in Personality* 35, 138–167.
14. Baron, R. A. (1983). The control of human aggression: An optimistic perspective. *Journal of Social and Clinical Psychology*, 1(2), 97 - 119.
15. Arnold, M. L., Pratt, M. W., & Hicks, C. (2004). Adolescents' representations of parents' voices in family stories: Value lessons, personal adjustment, and identity development. In M. Pratt & B. Fiese (Eds.), *Family stories and the life course: Across time and generations* (pp. 163 - 186). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, Publishers.
16. Dundes, L. (1994) Punishing parents to deter delinquency: A realistic remedy. *Am. J. Police*, 13, 113.
17. Davidov, M., & Grusec, J. E. (2006). Untangling the links of parental responsiveness to distress and warmth to child outcomes. *Child development*, 77(1), 44 - 58.
18. Allen, P. A., Aber, J. L., & Leadbetter, B. J. (1990). Adolescent problem behaviors: The influence of attachment and autonomy. *Psychiatric Clinics of North America*, 13(3), 455 - 467.
19. Collins, W. A., & Repinski, D. J. (1994). Relationships during adolescence: Continuity and change in interpersonal perspective. In R. Montemayor, G. Adams, & T. Gullotta (Eds.), *Personal relationships during adolescence* (pp. 1 - 36). Thousand Oaks, CA: Sage.
20. Cleary, S. D. (2000). Adolescent victimization and associated suicidal and violent behaviors. *Adolescence*, 35(140), 671.
21. Cassidy, J., & Berlin, L. J. (1994). The insecure/ambivalent pattern of attachment: Theory and research. *Child Development*, 65, 971 - 991.
22. Casas, J. M. (1998). *Multicultural counseling competencies: Individual and organizational development* (Vol. 11). Sage Publications. (aksesuar më: 28/11/2017)
23. Broidy, L. M. (2003). Developmental trajectories of childhood disruptive behaviors and adolescent delinquency: a six - site, cross - national study. *Developmental psychology*, 39(2).
24. Allen, J. P., Marsh, P., (2002). Attachment and autonomy as predictors of the development of social. New York: Guilford Press.
25. Allen, J. P., & Land, D. (1999). Attachment in adolescence. In J. Cassidy & P. Shaver (Eds.), *Handbook of attachment: Theory, research and clinical implications* (pp. 319 - 335). New York: Guilford Press.
26. Kevin J. Simons Carl E. Paternite, Shore. C, (2001) Quality of Parent/Adolescent Attachment and Aggression in Young Adolescents, *Journal of Early Adolescence*, Vol. 21 No. 2.
27. Buss, A. H., & Perry, M. (1992). The Aggression Questionnaire. *Journal of Personality and Social Psychology*, 63, 452 - 459.